VENDIM
Nr. 97/2016

PËR MBYLLJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, dhe të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me kërkesën e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm për Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të deklarojë të mbyllur veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

II. 27 projektligjet e hartuara dhe të depozituara në Kuvend nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, i ngritur pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, të shqyrtohen dhe të miratohen nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në përputhje me rregullat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit.

III. Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik, i ngritur në bazë të vendimit të Kuvendit nr. 96/2014 dhe vendimet e Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për reformën në sistemin e drejtësisë"[1], të vazhdojnë të mbështesin Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për shqyrtimin dhe miratimin e 27 projektligjeve të hartuara.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.12.2016

[1] Vendimi nr. 2, datë 22.12.2014, vendimi nr. 3, datë 22.12.2014, vendimi nr. 4, datë 22.12.2014, vendimi nr.7, datë 23.1.2015 dhe vendimi nr. 8, datë 23.1.2015.